



**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUATOR
GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012**

**1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË
TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012**

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur
(në milionë lekë*).

DATA	R/REPO një-javore	R/REPO ditore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
05.01.2012	16,000.00			
12.01.2012	19,200.00			2,000.00
19.01.2012	15,800.00			
24.01.2012				2,550.00
26.01.2012	18,200.00			
02.02.2012	15,500.00			2,000.00
09.02.2012	16,980.00			2,000.00
16.02.2012	19,000.00			
23.02.2012	15,500.00	-6,230.00		
01.03.2012	14,700.00			2,000.00
08.03.2012	11,000.00			
15.03.2012	14,770.00			
23.03.2012	12,500.00	-6,000.00		
29.03.2012	12,000.00			

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim dhe tërheqje të likuiditetit.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar është rritur nga mesatarisht 21.9 miliardë lekë në fund të muajit dhjetor, në mesatarisht 22.8 miliardë lekë në tremujorin e parë të vitit 2012.

Për injektimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 15.47 miliardë lekë

në javë*, si dhe marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor, e cila u përdor në 5 raste, mesatarisht 2.1 miliardë lekë për ankand. Për të mundësuar tërheqjen e

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

likuiditetit të tepërt në datat 23.02.2012 dhe 23.03.2012 , të cilat përkonin dhe me dy ditët e fundit të dy periudhave të njëpasnjëshme të mbajtjes së rezervës së detyruar, u përdor instrumenti marrëveshje riblerje me maturim njëditor, në nivelin mesatar 6.1 miliardë lekë.


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, depozita njëditore u përdor në 18 raste, mesatarisht 1.78 miliardë lekë, gati 1.57 miliardë lekë më shumë se në tremujorin e kaluar kur ky instrument ka regjistruar të njëjtën frekuencë përdorimi por një mesatare prej 0.21 miliardë lekësh.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 12 raste, mesatarisht 0.21 miliardë lekë, kundrejt 3 rasteve të tremujorit të kaluar me një mesatare 0.03 miliardë lekë. Përqendrimi më i lartë i përdorimit, ka qenë në periudhën 12-23 janar dhe kryesisht në ditët e fundit të periudhës së rezervës së detyruar.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2011-2012.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2011-2012 (me çmim blerjeje).



2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, duke blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë me objektiv rritjen e rezervës valutore. Blerjet e valutës së Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe shënuan 137.99 milionë lekë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe, kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Kjo e fundit ka kryer pagesat e borxhit të jashtëm kryesisht me anë të fondeve të saj, dhe për këtë qëllim, ka blerë edhe valutë në masën 832.2 milionë lekë nga Banka e Shqipërisë, fonde të cilat Ministria e Financave ja kishte shitur Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të kaluar. Edhe gjatë këtij tremujori, kanë vazhduar të lidhen kontratat *swap* në valutë dhe lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave në funksion të menaxhimit të likuiditetit të Ministrisë së Financave. Blerjet e valutës së BSH-së nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe shënuan 2,238.6 milionë lekë, ndërsa shitjet 3,074.8 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 163.4 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	2,238.6	3,074.8
TË TJERA (IDA, IBRD)	163.4	